REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUKËS**

**DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT**

# P/VENDIM

**Nr. 22 Datë 27.05.2025**

**PËR**

## MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NE BUXHETIN E VITIT 2025

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54/dh, 55/3, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" nenet 6,10,22,28,40,41, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", *(i ndryshuar),* nenet 6,15,44, ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",*(i ndryshuar)*, Ligjin Nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", *(i ndryshuar)* pikat 94,96,100,113,120,122, Udhëzimin Plotësues Nr.2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimin Nr.3 datë 28.02.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027", Udhëzimin Plotësues Nr.8 datë 05.07.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027", Vendimin e Këshillit Bashkisë Nr.91 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 sipas SMBV", Shkresën nr.1/21 datë 06.01.2025, "Verifikimi i ligjshmërisë së aktit",Shkresën Nr.479 Prot. date 23.05.2025, Shkresën Nr.200 Prot. datë 24.02.2025, Shkresën Nr.450 prot. datë 20.05.2025, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

**MIRATIM:**

1. Shtesa ne listen e prioriteteve te Bashkisë Kukës, si me poshtë vijon:

| Nr. | Emertimi | Shuma |
|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion i Salles se Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak | 2,830,756 |
| 2 | Rrethim i Varrezave te Qytetit te Kukesit | 19,007,224 |
| 3 | Rrethim i Vend-Depozitimit te Mbeturinave ne Myc Mamez | 2,745,452 |
| 4 | Rikonstruksion i Ambjenteve te ish ASHK-se,Bashkia Kukes | 4,449,291 |
| 5 | Rehabilitimi Urban i Qendres se Fshatit Shemri dhe Rikonstruksion i Hapesirave Edukative dhe Sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme | 60,065,893 |
| 6 | Rikonstruksion i Katit Perdhe dhe Katit te Pare te Godines se Bashkise Kukes | 2,415,527 |

**2.** Të miratojë shtesat në Planin e Investimeve Kapitale të Bashkisë Kukës si vijon:

| Nr. | Emertimi | Viti 2025 | Viti 2026 |
|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion i Salles se Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak | 2,830,756 | |
| 2 | Rrethim i Varrezave te Qytetit te Kukesit | 19,007,224 | |
| 3 | Rrethim i Vend-Depozitimit te Mbeturinave ne Myc Mamez | 2,745,452 | |
| 4 | Rikonstruksion i Ambjenteve te ish ASHK-se,Bashkia Kukes | 4,449,291 | |
| 5 | Rehabilitimi Urban i Qendres se Fshatit Shemri dhe Rikonstruksion i Hapesirave Edukative dhe Sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme | 47,691,592 | 12,374,301 |
| 6 | Rikonstruksion i Katit Perdhe dhe Katit te Pare te Godines se Bashkise Kukes | 2,415,527 | |
| 7 | Blerje paisje kompjuterike per nevojat e Bashkise Kukes dhe Njesive Administrative | 6,000,000 | |
| 8 | Blerje paisje per median | 960,000 | |
| 9 | Projekt Propozim Reload II-Memorandumi i Bashkepunimit ndermjet Bashkise Kukes dhe UNDP-se | 3,000,000 | |
| 10 | Blerje 2 automjeteve ( kamionçina) te perdorura per nevoja te Bashkise Kukes | 3,600,000 | |
| **TOTALI** | | **92,699,842** | **12,374,301** |

3. Burimet e fondeve për shumen 92,699,842 leke janë:

Fondet e papërdorura të të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 sipas Akt Rakordimit Nr.71 Prot. datë 31.01.2025 me Degën e Thesarit Kukës, sipas tabelës së mëposhtme:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Fondet e trashëguara nga viti 2024 te paperdorura | 98,827,109 |
| 2 | Te alokuara - Vendosja e Monumentit Shqiponja | -6,127,267 |
| | **TOTALI:** | **92,699,842** |

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut dhe më pas do t`i dërgohet Degës se Thesarit Kukës për regjistrimin në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.

**KRYETARI**

**Albert HALILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KUKËS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUKËS**

# RELACION

# KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS

# PËR

# MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NE BUXHETIN E VITIT 2025

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.3/c, 54/dh, 55/3, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.68/2017, te miratuar me date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" nenet 6,10,22,28,40,41, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", *(i ndryshuar),* nenet 6,15,44, ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",*(i ndryshuar)*, Ligjin Nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin e Ministrise se Financave Nr.2, datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit", *(i ndryshuar)* pikat 94,96,100,113,120,122, Udhëzimin Plotësues Nr.2, datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimin Nr.3 datë 28.02.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027", Udhëzimin Plotësues Nr.8 datë 05.07.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027", Vendimin e Këshillit Bashkisë Nr.91 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 sipas SMBV", Shkresën nr.1/21 datë 06.01.2025, "Verifikimi i ligjshmërisë së aktit",Shkresën Nr.479 Prot. date 23.05.2025, Shkresën Nr.200 Prot. datë 24.02.2025, Shkresën Nr.450 prot. datë 20.05.2025, ju paraqesim P/Vendimin:

***Projekt – Vendimin për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2025,***

Bashkia Kukës, si organ i vetëqeverisjes vendore ka të drejtë, sipas kërkesave te përcaktuara ne ligjin Nr.139/2015 date 17.12.2015, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor, qe të bëjë rishikimin e buxhetit të miratuar në përputhje me realizimin e të ardhurave dhe me ndryshimin e prioriteteve gjatë vitit.

*"Buxheti"* si tëresia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes vendore, është miratuar me vendim Nr.91, datë 27.12.2024 te Këshillit Bashkiak Kukës "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 sipas SMBV", si dhe është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës me Shkresën nr.1/21 datë 06.01.2025, "Verifikimi i ligjshmërisë së aktit".

Projekt Vendimi për një ndryshim në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2025, është një faktor i cili sjell përmirësimin e menaxhimit të financave publike, si dhe është hartuar në bazë të elementëve te mëposhtëm:

1. Rivlerësimit të programeve buxhetor.
2. Fondet e papërdorura të transfertës së pakushtëzuar të trashëguar nga viti 2024 sipas Akt Rakordimit Nr.71 Prot. datë 31.01.2025 me Degën e Thesarit Kukës të buxhetohen sipas tabelave te meposhtme
3. Analizës financiare të zbatimit të buxhetit të vitit 2025.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështetur mbi nenin nr. 44, date ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" kanë kompetencë të plotë në shpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve me Vendim të Këshillit Bashkiak, me qëllim financimin e plotë të nevojave të krijuara gjatë vitit financiar, si dhe të ofrojnë një gamë (volum) të gjerë shërbimesh publike. Këto shërbime janë pjesë e funksioneve të veta të vetëqeverisjes vendore të përcaktuara me ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Disa nga këto funksione janë:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike;
- Shërbimet sociale;
- Kultura, sporti dhe shërbimet rekreative;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat, natyra dhe biodiversiteti;
- Zhvillimi ekonomik vendor;
- Siguria publike;
- Etj.

Bashkia Kukës me Projekt Vendimin për disa ndryshime në buxhetin e Bashkisë Kukës për vitin 2025, synon që të mbështesë politikat vendore në funksion të zhvillimit ekonomik, por pa cënuar shërbimet bazë të sipërcituara.

Në bazë të kerkeses se Drejtorise se Planifikimit,Kontrollit dhe Zhvillimit te Territorit kemi nje shtese ne listen e prioriteteve te Bashkise Kukes per vitin 2025 sipas tabeles se meposhtme :

| Nr. | Emertimi | Shuma |
|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion i Salles se Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak | 2,830,756 |
| 2 | Rrethim i Varrezave te Qytetit te Kukesit | 19,007,224 |
| 3 | Rrethim i Vend-Depozitimit te Mbeturinave ne Myc Mamez | 2,745,452 |
| 4 | Rikonstruksion i Ambjenteve te ish ASHK-se,Bashkia Kukes | 4,449,291 |
| 5 | Rehabilitimi Urban i Qendres se Fshatit Shemri dhe Rikonstruksion i | 60,065,893 |

| | | |
|---|---|---|
| | Hapesirave Edukative dhe Sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme | |
| 6 | Rikonstruksion i Katit Perdhe dhe Katit te Pare te Godines se Bashkise Kukes | 2,415,527 |

Nga ana e Drejtorise se Finances dhe Buxhetit,referuar kerkeses se Drejtorise se Planifikimit,Kontrollit dhe Zhvillimit te Territorit Nr.479 Prot. date 23.05.2025, Kerkeses se Drejtorise se IT-se,Komunikimit dhe Inovacionit Nr.200 Prot. date 24.02.2025,Kerkeses se Drejtorise se Sherbimeve Komunitare Nr.450 Prot. date 20.05.2025,Kerkeses se Drejtorise se Integrimit Europian,Diaspores dhe Migracionit Nr.1585 Prot. date 25.10.2024, Kerkeses se Drejtorise se IT-se,Komunikimit dhe Inovacionit Nr.472 Prot. date 23.05.2025, eshte bere nje shtese ne planin e Investimeve Kapitale te vitit 2025 sipas tabeles se meposhtme :

| Nr. | Emertimi | Viti 2025 | Viti 2026 |
|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion i Salles se Mbledhjeve te Keshillit Bashkiak | 2,830,756 | |
| 2 | Rrethim i Varrezave te Qytetit te Kukesit | 19,007,224 | |
| 3 | Rrethim i Vend-Depozitimit te Mbeturinave ne Myc Mamez | 2,745,452 | |
| 4 | Rikonstruksion i Ambjenteve te ish ASHK-se,Bashkia Kukes | 4,449,291 | |
| 5 | Rehabilitimi Urban i Qendres se Fshatit Shemri dhe Rikonstruksion i Hapesirave Edukative dhe Sportive te Shkolles se Mesme te Pergjithshme | 47,691,592 | 12,374,301 |
| 6 | Rikonstruksion i Katit Perdhe dhe Katit te Pare te Godines se Bashkise Kukes | 2,415,527 | |
| 7 | Blerje paisje kompjuterike per nevojat e Bashkise Kukes dhe Njesive Administrative | 6,000,000 | |
| 8 | Blerje paisje per median | 960,000 | |
| 9 | Projekt Propozim Reload II-Memorandumi i Bashkepunimit ndermjet Bashkise Kukes dhe UNDP-se | 3,000,000 | |
| 10 | Blerje 2 automjeteve ( kamionçina) te perdorura per nevoja te Bashkise Kukes | 3,600,000 | |
| **TOTALI** | | **92,699,842** | **12,374,301** |

Persa i perket burimeve te fondeve, referuar edhe Akt-Rakordimit Nr.71 Prot. date 31.01.2025 te mbajtur me Degen e Thesarit Kukes, do te mbulohen nga te ardhurat e paperdorura te vitit 2024.

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Fondet e trashëguara nga viti 2024 te paperdorura | 98,827,109 |
| 2 | Te alokuara - Vendosja e Monumentit Shqiponja | -6,127,267 |
| **TOTALI:** | | **92,699,842** |

Bashkengjitur ketij projekt-vendimi gjenden dhe Shkresat e sipercituara se bashku me preventivat perkatese.

Ju faleminderit.

**DREJTORI**

**Ramiz HERENI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E FINANCAVE**
**DREJTORIA E THESARIT**
**DEGA KUKES**

Nr 71 Prot. Kukes me, **31.01.2025**

# AKT-RAKORDIM

I mbajtur sot me daten 31.01.2025 ne prani te Deges

Thesarit me perfaqesues **Pergjegjes Dege Enver Dema** dhe Perfaqsuesit te **Bashkise Kukes Kryetari Albert Halilaj** mbi te ardhurat e trazheguara nga viti 2024 per vitin 2025 sipas tabeles bashkengjitur

Ne shumen me kapitull **01 -283.601.841.50** lek dhe me kapitull **05-164,431,248.50**

Bashkise kukes i trashegohen **ne total 448.033.090**(kateqind e dyzet e tete miljon tridhjete e tre mije e nentedhjete ) lek.

Ne vemendje kjo shume duhet te shpendahet me VKB. sipas strukturave perkatese te mbartjes dhe kontratave aktuale te pa paguara ndersa pjesa tjeter sipas nevojave te institucionit tashme te rakorduara me drejtorine e finances .

**Pergjegjesi i Deges**
**Enver Dema**

**Kryetari Bashkise**
**Albert Halilaj**

| | DEGA THESARIT KUKES | TABELA E GRANTI DHE TE ARDHURAT E VITIT 2024 QE DO TE TRASHEGOHEN PER VITIN 2025 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emertimi I Institucionit | Ent | Min | Progr | kapit | Tdo | 6009999 | 6029999 | 2319999 | 6999999 | TOTALI |
| 1 | Bashkia Kukes | 125 | 00 | 01110 | 01 | 1818 | 57795186 | 137726545 | 1593948 | 86486162.5 | 283601841.5 |
| 10 | Bashkia Kukes | 125 | 00 | 00000 | 05 | 1818 | 11546 | 24762432 | 40830161 | 98827109.47 | 164431248.5 |
| | TOTALI | | | | | | 57806732 | 162488977 | 42424109 | 185313272 | 448033090 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
**BASHKIA KUKËS**
**+DREJTORIA E PLANIFIKIMIT KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Nr. 478 Prot. Kukës me, 23.05.2025

Lënda: Kërkesë

Drejtuar: DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Ju drejtohemi me këtë kërkesë për përfshirjen në listën e prioriteteve të investimeve, projektet e zbatimit si më poshtë:

- Rrethimi i varrezave publike në qytetin e Kukësit
- Rrethimi i vend-depozitimit të mbeturinave në Myç/Mamëz
- Rikonstruksion i ish zyrave të A.SH.K-së Kukës
- Rikonstruksion i sallës së mbledhjeve të Keshillit Bashkiak (Kati III-të), Bashkia Kukës
- Rehabilitimi urban i qendrës së fshatit Shëmri dhe rikonstruksioni i hapsirave edukative dhe sportive të shkollës së mesme të përgjithshme.
- Rikonstruksion i katit përdhe dhe katit I-rë të godinës së Bashkisë Kukës

Bashkëngjitur gjeni projektet dhe preventivat për secilin nga objektet e sipërshënuar.

*Faleminderit për mirëkuptimin!*

**KRYETARI**

**Albert HALILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KUKËS

# BASHKIA KUKËS

**DREJTORIA IT, KOMUNIKIMIT DHE INOVACIONIT**

Nr. 472 Prot. Kukës me, 23. 5.2025

**Lenda:** Kerkese blerje Kompjutera dhe Printera

**Drejtuar:** Drejtorise Juridike dhe Prokurimeve publike

Drejtorise se Finances dhe Buxhetit

**KUKES**

Duke mare shkas nga kerkesat e vazhdueshme te Drejtorive te Bashkise Kukes dhe Njesive Administrative, per shkak te gjendjes se amortizuar te paisjeve kompjuterike si PC dhe Printer, kerkojme nga ana Juaj marrjen ne konsiderate per akordimin e nje fondi sipas mundesive per Blerjen e Kompjuterave dhe Printerave per nevoja te Bashkise Kukes.

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj.

**KRYETARI**

**Albert HALILAJ**

Sheshi "Skënderbej", Kukës, Lagja 5, Kodi Postar: 8500, Telefon: (024) 225-110, Web: kukesi.gov.al, E-mail: info@kukesi.gov.al

## BASHKIA KUKËS
**DREJTORIA IT, KOMUNIKIMIT DHE INOVACIONIT**

Nr.200____Prot. Kukës me, 24.02.2025

**Lenda:** Kerkese per blerje paisje multimedia

**Drejtuar:** Drejtorise Juridike dhe Prokurimeve Publike

->Drejtorise Finances Dhe Buxhetit

**KUKES**

Per nevoja te aktiviteteve te Bashkise Kukes , Drejtoria e IT, Komunikimit dhe Inovacionit kerkon blerjen e paisjeve per Media.

Bashkangjitur eshte preventivi .

Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj.

**KRYETARI**

**Albert HALILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KUKËS

Sheshi "Skënderbej", Kukës, Lagja 5, Kodi Postar: 8500, Telefon: (024) 225-110, Web: kukesi.gov.al, E-mail: info@kukesi.gov.al

Data: 18.02.2025

Preventiv per blerje paisje multimedia

| Nr. | Emertimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Trup Kamera Mirrorles | Cope | 1 | 370.000 | 370.000 |
| **2** | Lente 70-200 | Cope | 1 | 300.000 | 300.000 |
| **3** | Lente 24-105 | Cope | 1 | 150.000 | 150.000 |
| **4** | Bateri | Cope | 2 | 20.000 | 40.000 |
| **5** | Karikues | Cope | 1 | 10.000 | 10.000 |
| **6** | Grip per kamera | Cope | 1 | 30.000 | 30.000 |
| **7** | Blic | Cope | 1 | 20.000 | 20.000 |
| **8** | Qante | Cope | 1 | 10.000 | 10.000 |
| **9** | Dron | cope | 1 | 60.000 | 60.000 |
| | *Shuma totale* | | | | **990.000** |

**BASHKIA KUKËS**

## DREJTORIA E SHËRBIMEVE KOMUNITARE

Nr. 450 Prot. Kukës më, 20.5.2025

**Lënda : Kërkesë për blerje automjete**

-> **Drejtuar: Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit**
**Drejtorisë Juridike,Prokurimeve Publike**

Drejtoria e Shërbimeve Komunitare bazuar në nevojat për automjete (2 kamioncina vetëshkarkuese) ,për kryerjen e shërbimeve të ndryshme dhe zgjerimin e shërbimeve në njësitë administrative ju drejtohet me këtë kërkesë për të paisur Drejtorin e Shërbimeve Komunitare me automjetet e më sipërme
Shpresojmë në mirkuptimin tuaj.

**KRYETARI**

**Albert HALILAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KUKËS

Sheshi "Skënderbej", Kukës, Lagja 5, Kodipostar: 8500, Telefon: (024) 225-110, Ëeb: kukesi.gov.al, E-mail:

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KUKËS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN, DIASPORES DHE MIGRACIONIT

Nr. 1565 Prot Kukës, më 25.10.2024

Lënda: Për parashikim në shpenzimet buxhetor për vitin 2025

Drejtuar: Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

Në vijmë të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimin ndërmjet Bashkisë Kukës dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), nënshkruar me datë 15.09.2021, Neni II "Fusha e Bashkëpunimit", pika v " Përgatitjen dhe zbatimin e ( të paktën) një thirrje publike për projekte të OSHC-ve të financuara plotësisht nga buxheti I Bashkisë Kukës, Brenda vitit 2024 dukë përdorur metodologjinë LOD", lutemi që:

Në parashikimet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2025, të parashikohet shumë prej 3.000.000 Lekësh (Letra e Interesit nga Bashkia) me qëllim shpalljen e thirrjes nga Bashkisë Kukës për projekt propozime për Organizatat e Shoqërisë Civile.

Bashkëngjitur gjeni Memorandumin e Bashkëpunimit dhe Letrën e Interesit për pjesëmarrjen në ReLOaDII.

Ju faleminderit.

**KRYETARI**

Albert HALILAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA KUKES

Sheshi "Skënderbej", Kukës, Lagjja 5, KodiPostar 8501, Telefon (024) 225 110, Web kukesi.gov.al, E mail: info@kukesi.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI BASHKIAK KUKËS**

**VENDIM**
**Nr 48, Datë 28.10.2021**

**PËR**

**MBI MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA DHE BASHKISË KUKËS SI DHE MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR ALOKIMIN E FONDEVE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE-METODOLOGJIA LOD**

Këshilli Bashkiak Kukës, në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pasi shqyrtoi projekt-vendimin dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Diasporës, Integrimit Europian dhe Migracionit, si dhe mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, Ligjit nr.8548, datë 11.11.1999 *"Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore"*, Ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 *"Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar)*, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Kukës Nr.4079 Prot, datë 16.09.2021, Drejtoria e Integrimit Evropian, Koordinimit dhe Informimit Publik,

**VENDOSI:**

**1-** Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Kukës.

**2-** Miratimin e Metodologjisë për Alokimin e Fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile (Metodologjia LOD).

**3-** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Diasporës, Integrimit Europian dhe Migracionit.

**4-** Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Anilda BIBA**

Sheshi "Skënderbej", Kukës, Lagja 5, Kodi postar: 850, Telefon: (024) 225 110, Web: kukesi.gov.al, E-mail: info@kukesi.gov.al